



## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT KRYETARI**

Nr. 1206/15 Prot.

Tiranë, më 30.06.2016

### **V E N D I M**

**Nr.83, Datë 30.06.2016**

#### **PËR**

### **EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR NË SHOQËRINË KORPORATA ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE (KESH) SHA, TIRANË “MBI ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË, RREGULLSHMËRISË SË VEPRIMTARISË EKONOMIKO- FINANCIARE”**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financimet e Huaja dhe Shoqërive Publike, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 15, 25 dhe 30 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

#### **V E N D O S A:**

**I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, të ushtruar në Shoqërinë Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) sha, Tiranë, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2015 deri më datë 31.12.2015.

**II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

#### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**I.** Mbi realizimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm.  
**Gjetje nga auditimi:**

Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, Sha, Tiranë, i kanë trajtuar me korrektesë rekomandimet e KLSH-së, dërguara me shkresën nr. 109/10, datë 07.07.2015, por nuk kanë marrë plotësisht masa për zbatimin e tyre. Konkretisht: Nga 22 masa organizative të rekomanduara, janë marrë në konsideratë dhe janë zbatuar plotësisht 2, në proces zbatimi 19 dhe nuk është pranuar 1.

Nga 11 masa zhdëmtimi të rekomanduara, 5 masa janë në proces zbatimi, 4 nuk janë zbatuar dhe 2 nuk janë pranuar.

Nga 20 masa disiplinore të rekomanduara, janë zbatuar plotësisht 14, janë zbatuar pjesërisht 4 masa dhe 2 masa nuk janë pranuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 38-38, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) Sha, Tiranë, të marrë masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së, të cilat nga auditimi rezultuan të pazbatuara, si dhe të ndjekë me vëmendje të posaçme ato të cilat janë në procese gjyqësore.

**Menjëherë dhe vazhdimisht**

## **II. Organizimi dhe funksionimi i Këshillit Mbikëqyrës dhe Administratorit, ligjshmëria e vendimeve të marra dhe zbatimi i tyre.**

### **II.1. Gjetje nga auditimi:**

Me vendim nr. 4, datë 24.02.2015 Këshilli Mbikëqyrës, ka vendosur miratimin e procedurës së pagesave të KESH sha në favor të HECE-ve të vegjël private e me koncesion për detyrimet për energjinë elektrike të furnizuar, si rezultat i efekteve të tarifave të rishikuara nga ERE për vitin 2013 dhe 2014.

Ky vendim është marrë me më pak se gjysma e anëtarëve, pra pa pasur kuorumin e mjaftueshëm të votave për të marrë vendime të vlefshme në përputhje me rendin e ditës, fakt i provuar (vërtetuar) nga libri i protokollit dhe vendimi i zbardhur, i cili është nënshkruar vetëm prej tre anëtarëve, për pasojë ky vendim është akt administrativ i pavlefshëm.

Vendimi është në kundërshtim me Ligjin 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni 116 "Aktet administrative absolutisht të pavlefshme", Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, neni 167, pika 5 dhe neni 162, pika 1 "Vendimet e këshillit të administrimit vlerësohen të vlefshme, nëse në procesin e vendimmarrjeve janë të pranishëm më shumë se një e dyta e anëtarëve.", pikën 7, neni 20 të statutit të shoqërisë të miratuar me VKM nr. 678, datë 03.10.2007, për një shtesë në VKM nr. 271, datë 09.05.1998 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e statutit tip të shoqërive anonime, shtetërore" ku citohet se "*Këshilli Mbikëqyrës mund të marrë një vendim të vlefshëm, në qoftë se janë të pranishëm jo më pak se pesë anëtarë të tij*", Udhëzimin e Ministrit të METE-s nr. 318, datë 08.04.2009 "Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore" paragrafi III, pika 5, ku përcaktohet "*Zhvillimi i mbledhjeve të Këshillit Mbikëqyrës dokumentohet në librin e protokollit nga sekretari i këshillit mbikëqyrës. Mbi bazën e protokollit të mbajtur zbardhen vendimet e këshillit mbikëqyrës*".

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendura më sipër ngarkon me përgjegjësi anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës që kanë marrë këtë vendim të përbërë [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], si dhe Kryetarin e Këshillit Mbikëqyrës [REDAKTUAR] (*Trajtuar më hollësisht në faqet 38-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

- Me vendim nr. 6 datë 31.03.2015 për një ndryshim në vendimin nr. 2, datë 25.02.2014, Këshilli Mbikëqyrës ka vendosur pajisjen me numër telefoni celular të punonjësve me funksione drejtuese në Shoqërinë KESH sha, në kundërshtim me VKM nr. 864, datë

23.7.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë”, pika 13, çka ngarkon me përgjegjësi anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës që kanë marrë këtë vendim të përbërë [redacted] kryetar, [redacted], [redacted], [redacted], [redacted] dhe [redacted] (Trajtuar më hollësisht në faqet 38-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

-Nga Këshilli Mbikëqyrës, të rishqyrtohet vendimi nr. 4, datë 24.02.2015 “Për miratimin e procedurës së pagesave të KESH sha në favor të HEC-eve të vegjël privat e koncesion për detyrimet për energjinë elektrike të furnizuar si rezultat i efekteve të tarifave të rishikuara nga ERE për vitin 2013 dhe 2014”. Ky vendim është marrë me më pak se gjysma e anëtareve, pra pa pasur kuorumin e mjaftueshëm të votave për të marrë vendime të vlefshme në përputhje me rendin e ditës, fakt i provuar (vërtetuar) nga libri i protokollit dhe vendimi i zbardhur , i cili është nënshkruar dhe zbardhur vetëm prej tre antarëve, në kundërshtim me Ligjin 8485, datë 12.05.1999 ”Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, VKM nr. 678, datë 03.10.2007, “Për miratimin e statutit tip të shoqërive anonime, shtetërore”, si dhe Udhëzimin e Ministrit të METE-s nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e këshillit mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, të merret vendimi përkatës.

-Nga Këshilli Mbikëqyrës, të rishqyrtohet vendimi nr. 6, datë 31.03.2015, për një ndryshim në vendimin nr. 2 , datë 25.02.2014 “Për pajisjen me numër telefoni celular të punonjësve me funksione drejtuese në shoqërinë KESH sha, në zbatim të VKM nr. 864, datë 23.7.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë”, të merret vendimi përkatës.

**Brenda datës 30.09.2016**

#### **II.2. Gjetje nga auditimi:**

- Me vendim nr. 20, datë 15.12.2015, Këshilli Mbikëqyrës ka vendosur dhënien e një shpërblimi të veçantë mbi pagë, në fund të vitit për punonjësit e Shoqërisë KESH sha, në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, neni 6, pika 1, si dhe ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodin e Punës”, i ndryshuar, neni 114 “Shpërblimi”, pika 2, vendim i cili është shoqëruar me efekt financiar për llogari të shoqërisë dhe buxhetit të shtetit në vlerën 36,560,005 lekë, çka ngarkon me përgjegjësi anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës që kanë marrë këtë vendim të përbërë [redacted] kryetar, [redacted], [redacted], [redacted], [redacted] dhe [redacted].

Në zbatim të këtij vendimi administratori ka nxjerrë urdhrin nr. 48, protokolluar me numër 10629/1 prot, datë 21.12.2015 për dhënien e shpërblimit financiar (paga 13) për punonjësit e Shoqërisë KESH sha (Trajtuar më hollësisht në faqet 38-41, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të merren masa që shpërblimet për punonjësit në fund të vitit, të jepen sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, dhe vetëm pas daljes dhe miratimit të rezultatit ekonomiko-financiar të shoqërisë me fitim dhe të miratuar nga Aksioneri i vetëm, “Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes”.

**Vazhdimisht**

### **III. Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.**

#### **III.1. Gjetje nga auditimi:**

-Shoqëria KESH sha, për vitin 2015 nuk ka miratuar nivelin e pagave nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS), si dhe në shkurt të vitit 2014 ka ndryshuar klasifikimin e shtesës mbi pagën për vjetërsi në punë, duke bërë një rritje të niveleve të saj duke sjellë dhe efekte financiare në rritje në zërin e shtesës së pagës për vjetërsi në punë, pa marrë asnjë miratim nga strukturat drejtuese, Këshilli Mbikëqyrës dhe MZHETTS, në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6, pika 1, shkronja a) (*Trajtuar më hollësisht në faqet 47-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**III.2.** Si rezultat i largimeve nga puna pa shkaqe të arsyeshme, Shoqëria KESH sha është penalizuar në vitin 2015, nga vendimet e gjykatave në 19 raste në vlerën 15,504,248 lekë, në 4 raste marrë nga përmbartimi me urdhër-ekzekutimi në vlerën 2,336,620 lekë dhe kosto përmbartimore në vlerën 692,753 lekë. Në total shuma e kërkuar në proceset gjyqësore dhe përmbartimore është për vlerën **18,533,621 lekë** në 23 raste, vlerë e cila përbën efekt negativ financiar për të ardhurat e Shoqërisë KESH sh a

a. Pavarësisht ndjekjes në të gjitha shkallët e gjykimit dhe kontestimeve nga shoqëria të vendimeve të gjykatave, për dëmshpërblimet, si pasojë e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, konstatohet se vendimet janë në shumicën e rasteve në favor të punonjësve të larguar dhe në të ardhmen do të shkaktojnë rëndim të situatës financiare të shoqërisë, duke çenuar zhvillimin normal të aktivitetit ekonomiko-financiar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 47-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**III. 3.** Nuk ka një rregullore të miratuar për mënyrën e rekrutimit të stafit. Nuk ka gjurmë për shpalljen e vendeve vakante dhe intervistimin ose testimin e kandidatëve, deri në përzgjedhjen e tyre. Përzgjedhja e punonjësve është bërë në përputhje me kriteret e vendosura për pozicionet, në lidhje me nivelin arsimor, përvojën në punë, formimin bazë etj, por procedura e ndjekur gjatë kësaj përzgjedhje nuk është e qartë dhe transparente (*Trajtuar më hollësisht në faqet 47-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

**1.** Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të merren masa për miratimin nivelit të pagave nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETTS), në zbatim të Ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6, pika 1, shkronja a.

**Brenda datës 30.09.2016**

**2.** Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të analizohen në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna, si dhe krijimin e detyrimeve të shtuara përmbartimore, duke evidentuar përgjegjësitë individuale, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për shoqërinë.

**Menjëherë dhe vazhdimisht**

**3.** Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, si dhe Departamenti Ekonomik, të analizojnë me saktësi numrin e fuqisë punëtore aktuale dhe ta harmonizojë atë me nevojën aktuale dhe perspektivën e organizimit dhe funksionimit të Shoqërisë, duke marrë në kohë masat e nevojshme organizative, procedurale dhe ligjore në këtë drejtim, duke nisur që në fazën e rekrutimit.

**Brenda datës 30.09.2016**

**IV. Auditim me zgjedhje sipas periudhave, mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj).**

**1.Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi në lidhje me procedurën e prokurimit me vlera të vogla, për periudhën objekt auditimi rezultoi se: Veprimet e kryera për blerjet e mallrave, materialeve dhe kryerja e shërbimeve, të cilat janë likuiduar me arkë dhe bankë, janë kryer me sistemin elektronik të APP-së, konform dispozitave ligjore.

-Në shtatë raste u konstatua copëtim fondi, kur vlera e përlogaritur për mallra, shërbime apo punë që përfshihen në një grup për shkak të ngjashmërisë së tyre, apo për shkak të funksionit të tyre, brenda vitit kalendarik me vlerë jo më të madhe se 100,000 lekë, e cila është në kundërshtim me udhëzimin nr. 3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të Vogël”, pika 8 (*Trajtuar më hollësisht në faqet 52-54, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

- Të merren masa nga Shoqëria “Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sha), Tiranë, që procedurat e prokurimit “Blerje me vlera të vogla”, të bëhen vetëm mbi bazën e një argumentimi ligjor për domosdoshmërinë e përdorimit të kësaj procedure.

**Menjëherë dhe vazhdimisht**

**V. Mbajtja e evidencës kontabile në qendër dhe në njësitë e vartësisë, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e bilancit nga organet drejtuese të shoqërisë, si dhe dërgimi dhe miratimi i tij në organet e vartësisë, analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit**

**V.1. Gjetje nga auditimi:**

-Shoqëria KESH sha, nuk ka përfunduar procesin e regjistrimit të aseteve në Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme përkatëse, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 54-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Të zbatohen procedurat ligjore nga Shoqëria “Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH sha), Tiranë, për të regjistruar në Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, të gjitha objektet që janë regjistruar në “Zërin troje” në kontabilitet.

**Brenda datës 31.12.2016**

**V.2.Gjetje nga auditimi:**

-Gjendja debitore dhe kreditore është në shifra shqetësuese për Shoqërinë KESH sha, megjithatë, nga organet drejtuese të saj, nuk është analizuar dhe shqyrtuar me përgjegjësi, si dhe nuk janë marrë masat e duhura për reduktimin e tyre.

Konkretisht gjendja debitore është në vlerën 118,231,934 mijë lekë për vitin 2014, ndërsa gjendja kreditore është në vlerën 106,683,840 mijë lekë. Duke ju referuar të ardhurave dhe shpenzimeve, gjendja debitore zë respektivisht 16 % të totalit të të ardhurave, ndërsa gjendja kreditore zë 15%, të totalit të shpenzimeve (*Trajtuar më hollësisht në faqet 54-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Detyrimet e ndërsjella me KESH Sha:**

-1. Mos shlyerja e detyrimit për energjinë elektrike të furnizuar nga OSHEE sha/CEZ Shpërndarjen në vlerën 17,837,927,287 lekë.

- 2. Fatura furnizimi energjie elektrike të KESH Sha, që nuk njihen/pranohen nga OSHEE në vlerën 9,098,903,201 lekë.
- 3. Fatura për kamatëvonesa në pagesat e OSHEE sha ndaj KESH sha, që nuk njihen nga OSHEE sha në vlerën 10,496,930,825 lekë.
- 4. Mos shlyerje e detyrimeve të OSHEE sha ndaj KESH sha, për huat afatgjatë në vlerën 11,227,127,273 lekë.
- 5. Transferimi i aseteve në vlerën 17,400,414 lekë.
- 6. Mos shlyerja e detyrimeve të OSHEE sha, ka detyruar KESH sha të marrë kredi afatshkurtra dhe hua shtetërore në vlerën 53,384,000 euro dhe 26,350,713,000 lekë (të mbartura ndër vite deri më 31.12.2015).
- 7. Problematika të mbetura pezull që në momentin e ndarjes/privatizimit të OSSH, në vlerën 1,884,044,485 lekë për periudhën 30.06.2008 deri më 31.12.2008.
- 8. Mos përmbushja e zbatimit të VKM nr. 126, datë 11.02.2015, për shuarje me kompensim në vlerën 9 miliardë lekë .
- 9. Gjendja e detyrimeve të OST sha ndaj KESH sha në vlerën 799,498,612 lekë.
- 10. Efektet financiare dhe tatimore në zbatim të Vendimeve të Entit Rregullator të Energjisë nr. 27, datë 16.02.2015, nr. 143, datë 26.12.2014 , nr. 144, datë 26.12.2014 dhe nr. 149, datë 24.12.2013, për çmimet e blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël privatë dhe koncesionarë, duke krijuar një të ardhur të munguar për KESH sha në vlerën 819,878,902 lekë dhe detyrim TVSH për Buxhetin e Shtetit në vlerën 10,377,244 lekë.
- 11. Problematika e detyrimeve ndërmjet KESH sha dhe Tatim Taksat në vlerën 7,385,578,424 lekë.
- 12. Problematika e detyrimeve ndërmjet KESH sha dhe Ministrisë së Financave në vlerën 1,330,000,000 lekë (*Trajtuar më hollësisht në faqet 54-64, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

- Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të analizojnë gjendjen debitore dhe kreditore më datë 31.12.2015, si dhe të marrë masat e nevojshme për reduktimin e tyre, përmes hartimit dhe miratimit të një plani afatgjatë.

**Brenda datës 30.09.2016**

- Organet drejtuese të shoqërisë të analizojnë shkaqet dhe faktorët që ndikojnë në humbjet e kësaj shoqërie, si dhe të marrin masat e nevojshme për të mundësuar drejtimin e shoqërisë, drejt rezultateve pozitive.

**Vazhdimisht**

-Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë KESH sha, Tiranë në zbatim të legjislacionit, por edhe me bashkëpunimin e të gjithë aktorëve, të marrë masat për shlyerjen e detyrimeve të ndërsjella, duke gjetur dhe propozuar zgjidhjet e nevojshme, qoftë edhe nëpërmjet mekanizmit të shuarjes me kompensim të detyrimeve të ndërsjella, i cili do të ndikojë në uljen e detyrimeve dhe përmirësimin e situatës financiare të sistemit energjetik në vend, duke ofruar në këtë mënyrë një pasqyrim më realist financiar të shoqërive që operojnë në tregun energjetik.

**Menjëherë dhe vazhdimisht**

**VI. Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave.**

**VI.1. Gjetje nga auditimi:**

Në një rast objekti është ndërtuar pa leje ndërtimi, veprim në kundërshtim me VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për disiplinimin dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, Ligjin 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit (*Trajtuar më hollësisht në faqet 64-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa që investimet për ndërtimet dhe rikonstrukcionet të kryhen me leje ndërtimi, në zbatim të Ligjit 107/2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit.

**Vazhdimisht**

### **VI.2. Gjetje nga auditimi:**

Në përlllogaritjen e vlerës të kontratës, nuk janë harmonizuar metodat e vendosura në aktet ligjore e nënligjore të prokurimeve, si dhe çmimet e botuara nga INSTAT-i, çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, janë mbështetur në studimin e tregut dhe sigurimin e ofertave për të njohur nivelin aktual të tregut, por nuk është dokumentuar nëse nga AK, janë kryer analizat e kostos së mallrave që do të prokurohen, duke krahasuar elementët e mësipërm me specifikimet teknike, në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit", neni 59 "Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës".

-Në hartimin e dokumenteve të tenderit, nuk janë dhënë argumentime mbi vendosjen e çdo kriteri të veçantë për kualifikim. Ky veprim bie në kundërshtim me Rregullat e Prokurimit Publik, të miratuara me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit".

-Specifikimet teknike nuk janë hartuar plotësisht në përputhje me nenin 23 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, pasi ato nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë marke apo emri të veçantë, patente, vizatimi ose tipi, origjinë specifike, prodhuesi ose sipërmarrje shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët "*ose ekuivalent*" të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

-Anulimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, është kryer pa analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për shkaqet subjektive që vërehen në procedurat e anuluar, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit". Arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë mjaftueshmërisht bindëse dhe duhet tu komunikohen të gjithë pjesëmarrësve në procedurën e prokurimit. Autoriteti kontraktor publikon njoftimin për anulimin e procedurës së prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç është publikuar njoftimi i kontratës, jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes së vendimit për anulim.

-Në 12 procedura tenderimi, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit", Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i procedurës administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, nenet 115-120, çka ngarkon me përgjegjësi komisionet e vlerësimit të ofertave.

-Në 1 procedurë tenderimi, nuk është paraqitur nga ana e operatorëve fitues, polica e sigurimit, në kundërshtim me nenin 25.2 të kushteve të përgjithshme të kontratës, ku në mënyrë eksplicite citon "Polica e sigurimit do të dorëzohet tek drejtuesi i projektit me

aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. Ky siguracion do të mbulojë kompensimin e kërkuar për të mbuluar humbjen e shkaktuar. Nëse kontraktori dështon të sigurojë policën e sigurimit, kontrata do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, AK, mund të vendos të zgjasë periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit, ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbrësë koston e tij, nga pagesa që i jep kontraktorit” (Trajtuar më hollësisht në faqet 64-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Për rritjen e efikasitetit në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedurë prokurimi në përmbushje të kriterëve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, duke siguruar që Autoriteti Kontraktor të pranohet oferta të cilat janë të përballueshme, të qëndrueshme, të pakushtëzuara dhe të plotësimit të nevojave të saj:

- Autoriteti Kontraktor, në vijim duhet të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim, që të sigurojë konkurrencën e nevojshme, si një nga parimet bazë të prokurimit në blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punimeve, për të arritur rezultate të dëshirueshme në efektivitetin e përdorimit të fondeve publike. Këto kërkesa duhet të kenë në konsideratë edhe faktin që të kushtëzojnë kualifikimin e operatorëve në vartësi të shlyerjes/ose jo të detyrimeve financiare ndaj KESH sha, zgjidhjes së njëanshme të kontratave, ose mos përmbushjes të të gjitha detyrimeve kontraktore. Ky rekomandim mbështetet në frymën e ligjit për prokurimin publik si dhe në rregullat e prokurimit publik;

Nga Administratori i shoqërisë t`i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ i operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi në disa raste konstatohet jo korrekt;

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të vlerësojë drejtë kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike të miratuara në dokumentet e tenderit, duke u mbështetur në dokumente zyrtare dhe fletë analiza të lëshuara nga organet kompetente;

- Për të përcaktuar përgjegjësinë individuale, të bëhet ndarja e detyrave ndërmjet anëtarëve të Njesisë së Prokurimit dhe të miratohet nga titullari i Autoritetit Kontraktor;

- Anulimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, të kryhet duke analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për arsyet e procedurave të anuluar, në zbatim të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”. Arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë mjaftueshmërisht bindëse dhe duhet tu komunikohen të gjithë pjesëmarrësve në procedurën e prokurimit;

**Menjëherë dhe vazhdimisht**

## **VII. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.**

### **VII.1. Gjetje nga auditimi:**

KESH Sha gjatë vitit 2015 ka marrë masa për zbatimin e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, duke u përpjekur për zbatimin e parimeve, rregullave, procedurave, strukturave administrative dhe metodave për funksionimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit në këtë njësi publike.

Njësia e Auditimit të Brendshëm, e organizuar në nivel Departamenti, ka zhvilluar aktivitetin e saj bazuar në Ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, Manualin e Auditimit të Brendshëm (MAB), Manualin Specifik të



Auditimit të Brendshëm (MSAB) në KESH sha, si dhe Udhëzimin nr. 12, datë 05.06.2012 “Mbi procedurat e kryerjes së veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik”.

Njësia e Auditimit të Brendshëm ka një numër të lartë të auditimeve për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve dhe nuk ka realizuar një mbulim të thelluar të procedurave të prokurimeve, si dhe auditimi i performancës është fokusuar në problematika të vështira për të nisur këtë lloj auditimi (*Trajtuar më hollësisht në faqet 127-132, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

-Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të merren masa për të ngritur një sistem të mirëfilltë për monitorimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, duke evidentuar problematika, përgjegjësi dhe rekomandime me afate konkrete, për një monitorim në vijueshmëri i këtij procesi.

-Departamenti i Auditit të brendshëm të përcaktojë fushat, sistemet dhe objektivat e auditimit duke u orientuar më shumë nga problematikat kryesore të evidentuara nga auditimi i KLSH-së, për ta bërë sa më efektive veprimtarinë e tyre në ndihmë të mirë menaxhimit të kësaj shoqërie publike.

**Menjëherë dhe vazhdimisht**

**VIII. Mbi zbatimin rregullave dhe procedurave të shitje-blerjes të energjisë elektrike.**

**VIII.1. Gjetje nga auditimi:**

Shoqëria KESH sha, ende nuk ka një plan të optimizimit të burimeve hidroenergetike mbi baza vjetore, mujore, javore dhe ditore, çka ka sjell si pasojë humbje të konsiderueshme të të ardhurave nga shitja e energjisë elektrike, si dhe shpenzime të tepërta pa efektivitet në rastin e blerjes së energjisë elektrike për Shoqërinë KESH sha, që në dy rastet cenon buxhetin e shtetit në tërësi (*Trajtuar më hollësisht në faqet 132-184, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

- Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të merren masa për krijimin dhe implementimin e një mekanizmi për vlerësimin e kushteve meteorologjike në periudha afat gjata dhe afat mesme, të cilat do të krijojnë mundësi Korporatës, të menaxhojë kushtet hidroenergetike të kaskadës, si dhe ato financiare.

**Brenda datës 31.12.2016**

**IX. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për dhënien dhe marrjen me qira të aktiveve afatgjata materiale.**

**IX.1. Gjetje nga auditimi:**

Në vitin 2015 në dhënien me qira të aktiveve afatgjata materiale, nga Njësia prodhuese HEC Fierzë të objektit (kontejner) “██████████”, i është referuar një baze ligjore të shfuqizuar, si dhe nuk është shoqëruar me dokumentacionin e plotë, pasi mungon a) propozimi për dhënien me qira të objektit, i cili përmban propozimin për veprimtarinë që mund të ushtrohet në këtë pasuri dhe afatin e dhënies me qira dhe vendimi i Këshilli Mbikëqyrës të ndërmarrjes. Megjithatë, duhet theksuar, se nuk ka pasoja financiare në të ardhurat e shoqërisë, pasi tarifa e vjelë është më e lartë se ajo dysheme e përcaktuar në VKM përkatëse (*Trajtuar më hollësisht në faqet 132-184, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Njësia prodhuese HEC Fierzë, të plotësojë dokumentacionin e nevojshëm për dhënien me qira të objektit (kontejner) “██████████” me sipërfaqe 70 m<sup>2</sup>, në përputhje me VKM nr. 54, datë

5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, duke nënshkruar pas kësaj kontratën përkatëse.

**Brenda datës 30.09.2016**

## **B.1 MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

### **1. Gjetje nga auditimi:**

Me vendim nr. 20, datë 15.12.2015, Këshilli Mbikëqyrës ka vendosur dhënien e një shpërblimi të veçantë mbi pagë, në fund të vitit për punonjësit e Shoqërisë KESH sha, para daljes së rezultatit financiar të shoqërisë, në kundërshtim me Ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, neni 6, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “*Organet kolegjiale drejtuese të njësisve të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare, me kapital mbi 50 % shtetëror, miratojnë: b) masën e shpërblimit të punës, por jo më shumë se një pagë mujore në vit, pas daljes së rezultatit financiar vjetor*”, si dhe Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodin e Punës”, i ndryshuar, neni 114 “Shpërblimi”, pika 2, vendim i cili është shoqëruar me efekt financiar për llogari të shoqërisë dhe buxhetit të shtetit në **vlerën 36,560,005 lekë**, çka ngarkon me përgjegjësi anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës që kanë marrë këtë vendim të përbërë [REDAKTUAR] kryetar, [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], antrarë.

Në zbatim të këtij vendimi administratori ka nxjerrë urdhrin nr. 48, protokolluar me numër 10629/1 prot, datë 21.12.2015 për dhënien e shpërblimit financiar (paga 13) për punonjësit e Shoqërisë KESH Sha (*Trajtuar më hollësisht në faqet 47-52, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë, të rishqyrtojë shpërblimin e dhënë për punonjësit e Shoqërisë për vitin 2015 në **vlerën 36,560,005 lekë** (shpërblime të dhëna para daljes së rezultatit financiar vjetor), duke analizuar rezultatit financiar faktik vjetor në zbatim të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare dhe Ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, si dhe të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës, vlerë e cila për Shoqërinë “Korporatën Energjetike Shqiptare” dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

**Brenda datës 31.12.2016**

### **2. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i zbatimit të procedurave të shit/blerjes së energjisë elektrike për vitin 2015 u konstatua, se Kompanitë [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], kanë realizuar marrëveshje të ndaluara në procedurat e shit/blerjes së energjisë elektrike, pasi kanë fshehur pozicionin e tyre të dyfishtë dhe kanë kryer tregti direkte të fshehtë, duke krijuar avantazh të paligjshëm, duke mos respektuar rregullat e konkurrencës, me pasojë dëm ekonomik për llogari të shoqërisë KESH Sha dhe Buxhetit të Shtetit në vlerën **1,265,151 euro**, ose e konvertuar me kursin e Bankës së Shqipërisë datës 26.02.2016 në **vlerën 167,958,171 lekë** (1,265,151 euro x 138.22 euro/lekë = 167,958,171.22 lekë).

Veprime në kundërshtim me; Ligjin nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës “ KREU I “ Marrëveshjet”, neni 4, Ligjin nr. 9754, datë 14.06.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë” neni 3 germa a.

Ky dëm ka ardhur pasi, ERE dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë me veprimet apo mosveprimet e tyre, kanë krijuar një situatë konfuzë në tregun e shit/blerjes së energjisë elektrike, duke e kthyer atë në një treg “OLIGOPOL”, duke dëmtuar në këtë mënyrë interesat e ligjshme të shoqërisë KESH sha, si dhe të Shtetit.

Tregu i shit/blerjes së energjisë elektrike për të gjitha shoqëritë që operojnë në këtë treg ( me kapital shtetëror dhe privat), është treg i derregulluar, për sa i përket çmimit, ndërsa procedura e prokurimit të energjisë elektrike, është e përjashtuar nga rregullat e Ligjit “Për prokurimin publik” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Dinamika e çmimeve ndryshon në disa raunde negociatash, që Shoqëria KESH sha ose Shoqëria OSHEE sha, kryejnë për shit/blerjen e energjisë elektrike, pra procesi në vetëvete, ngre hipoteza mbi mungesën e transparencës, pasi në tre raundet e para publikohet vetëm çmimi dhe jo sasia e ofruar, që sipas Shoqërisë KESH Sha ose Shoqërisë OSHEE sha, bëhet për të siguruar ose shitur sasinë e energjisë me synimin respektiv, uljen ose rritjen e çmimeve të ofruara.

Në këtë treg sot janë të licencuar 66 operatorë për tregtim të energjisë elektrike, por shoqëria KESH sha ose shoqëria OSHEE sha, u dërgon ftesën për ofertë rreth 29 operatorë dhe paraqiten si pjesëmarrës në procedurë vetëm 7-8 operatorë. *Pra, ofertat janë inelastike.*

Numri i kompanive pjesëmarrëse në procedurat e shit/blerjes së energjisë elektrike, që kanë lidhur kontrata furnizimi është i kufizuar. Janë pothuajse të njëjtat kompani që marrin pjesë dhe shpallen fituese pas katër proceseve negociimi, pra katër ose pesë kompani, gjë e cila ka çuar në ulje të konkurrencës ndërmjet pjesëmarrësve.

Gjatë procedurave të shit/blerjes së energjisë operatorët të cilët i përkasin të njëjtit grup, siç janë kompanitë ████████, ████████, ████████, për vitin 2015 kanë paraqitur dhe kanë dalë fitues me oferta të veçanta. Kjo ka çuar në ulje të konkurrencës, *pasi nuk mund të konkurrojnë me njëra tjetrën kompani të të njëjtit grup.* Pra, tregu përveç se ka numër të kufizuar pjesëmarrësish, ka edhe pjesëmarrje të të njëjtit grup që paraqiten me oferta të veçanta.

Edhe Autoriteti i konkurrencës, me vendim nr. 388, datë 14.12.2015 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në “Tregun e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes” dha disa rekomandime për Entin Rregullator të Energjisë dhe Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE), pra veprimet e ndërmarra nga Shoqëria ████████ në procedurat e blerjes së energjisë elektrike, i ka vlerësuar se bien ndesh me dispozitë për konkurrencën.

Theksojmë se KLSH, këtë fakt e ka konstatuar si vetmi institucion në Republikën e Shqipërisë në Shtator 2015 gjatë auditimit të OSHEE, për të cilin ka kërkuar masa për shpërbllim dëmi dhe masa disiplinore (*Trajtuar më hollësisht në faqet 132-184, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Të shqyrtohet nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë **vlera 1,265,151 euro**. Kjo vlerë ka të bëjë me realizim të marrëveshjeve të ndaluara në procedurat e shit/blerjes së energjisë elektrike për vitin 2015, nga Kompanitë ████████, ████████, ████████, pasi kanë fshehur pozicionin e tyre të dyfishtë dhe kanë kryer tregti direkt të fshehtë, duke krijuar avantazh të paligjshme, duke mos respektuar rregullat e konkurrencës.

Veprime në kundërshtim me;

Ligjin nr. 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës “ KREU I “ Marrëveshjet”, neni 4, Ligjin nr. 9754, datë 14.06.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë” neni 3 germa a.

***Vlera 1,265,151 euro për shoqërinë KESH sha dhe Buxhetit të Shtetit, përbën dëm ekonomik, dhe duhet të dëmshpërblehet nga:***

- [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED] në vlerën 579,717 euro
- [REDACTED] dhe [REDACTED] në vlerën 656,434 euro
- [REDACTED] dhe [REDACTED] në vlerën 29,000 euro.

**Brenda datës 31.12.2016**

### **3. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i shitblerjes së energjisë elektrike, u konstatua se janë kryer transaksione shit/blerje të energjisë elektrike nga [REDACTED], [REDACTED], edhe pas privatizimit të tyre. Konkretisht: Shoqëritë [REDACTED] dhe [REDACTED] njoftuan ndërprerjen e marrëdhënieve kontraktuale me shoqërinë KESH sha, respektivisht me shkresat datë 13.05.2013 dhe 23.05.2013.

Nga ana e tjetër, Shoqëria KESH sha me shkresat nr. 2894/2 prot., dhe nr. 2590 prot., datë 31.05.2013, njoftoi shoqëritë dhe vuri në dijeni shoqërinë OST sha. dhe ERE që marrëdhëniet kontraktuale me këto shoqëri ndërpriteshin që prej 1 Qershor 2013 dhe mbas kësaj date KESH sha, nuk do të pranojë asnjë program të prodhimit të energjisë elektrike duke filluar nga ora 00:00 e datës 1 Qershor 2013.

Megjithatë, pavarësisht përfundimit të marrëdhënieve kontraktuale, shoqëria KESH sha, ka vazhduar të faturojë energjinë elektrike të prodhuar nga këto shoqëri, shoqërisë OSHEE sha, për periudhën 1 Qershor deri me 31 Tetor 2013. Energji kjo e pa kontraktuar me kontratë dhe e faturuar shoqërisë OSHEE sha me çmimin 2.2 lekë/kwh (*Trajtuar më hollësisht në faqet 132-184, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Të shqyrtohet nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë **vlera 37,593,544 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me kryerjen e transaksioneve të shit/blerjes së energjisë elektrike nga [REDACTED], [REDACTED], pas ndërprerjes së marrëdhënieve kontraktuale me shoqërinë KESH sha, dhe respektivisht me shkresat bashkëlidhur të datave 13.05.2013 dhe 23.05.2013, si dhe të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës, **vlerë e cila për Shoqërinë KESH sha dhe Buxhetit të Shtetit, përbën dëm ekonomik.**

**Brenda datës 31.10.2016**

### **4. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt “Blerje pjesë këmbimi për nevoja KESH sha”, viti 2015, me shoqërinë “[REDACTED]” shpk, u konstatua se dokumentacioni shoqëruar i pajisjeve (test raporti i fabrikës) me **vlerë 7,200,000 lekë**, nuk është i plotë dhe i saktë.

Veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10,489 datë 15.12.2011 “Për trajtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore”, neni 3 pika 11, 12, 16, 17, 18, 21 neni 8, neni 9 dhe neni 10, si dhe VKM nr. 369, datë 27.3.2008 Për miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve elektrike, të projektuara për përdorim brenda disa kufijve të tensionit”.

Grupi i Auditimit referuar praktikës dokumentare të vënë në dispozicion, e cila rezultoi e pasaktë dhe me mangësi, nuk mund që të konfirmojë që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “[REDACTED]” shpk, ka fituar tenderin dhe është likuiduar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 64-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një Grupi teknik me specialistë të fushës (përjashtuar ata që kanë marrë pjesë në kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të pajisjeve), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e pajisjeve, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar

(specifikimeve teknike), si dhe të verifikojë gjendjen e tyre teknike pas vendosjes në punë, nëse kanë qenë ose jo problematike.

Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se pajisjet e furnizuara nga shoqëria "██████████" shpk, nuk janë autentike, nuk janë konform specifikimeve teknike të përcaktuar në procedurën e tenderimit, dhe gjendja e tyre teknike pas vendosjes në punë ka qenë problematike (defekte etj), **konsiderohet dëm ekonomik** dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit **arkëtimi i vlerës 7,200,000 lekë** nga shoqëria "██████████" shpk. Kjo çështje do të verifikohet nga KLSH-ja, në vijimësi në programet e zbatimit të rekomandimeve.

**Brenda datës 31.10.2016**

### **5. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt "Instalim i sistemit të ventilim-kondicionimit (██████████) në ndërtesën HEC Fierzë", viti 2015, me shoqërinë "██████████" shpk, u konstatua se dokumentacioni shoqëruar i pajisjeve "Certifikatë e origjine, test raporti i fabrikës, faturat e furnitorit, certifikatën e siguracionit, certifikata e garancisë, dokumentin e transportit (CMR), listë paketimin etj" me **vlerë 76,182,252 lekë**, nuk është i plotë dhe i saktë.

Veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10,489 datë 15.12.2011 "Për trajtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore", neni 3 pika 11, 12, 16, 17, 18, 21 neni 8, neni 9 dhe neni 10, si dhe VKM nr. 369, datë 27.3.2008 Për miratimin e rregullit teknik "Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve elektrike, të projektuara për përdorim brenda disa kufijve të tensionit".

Grupi i Auditimit referuar praktikës dokumentare të vënë në dispozicion, e cila rezultoi e pasaktë dhe me mangësi, nuk mund që të konfirmojë që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën shoqëria "██████████" shpk, ka fituar tenderin dhe është likuiduar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 64-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një Grupi teknik me specialistë të fushës (përfshijtur ata që kanë marrë pjesë në kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të pajisjeve), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e pajisjeve, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), si dhe të verifikojë gjendjen e tyre teknike pas vendosjes në punë, nëse kanë qenë ose jo problematike.

Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se pajisjet e furnizuara nga shoqëria "██████████" shpk, nuk janë autentike, nuk janë konform specifikimeve teknike të përcaktuar në procedurën e tenderimit, dhe gjendja e tyre teknike pas vendosjes në punë ka qenë problematike (defekte etj), **konsiderohet dëm ekonomik** dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit **arkëtimi i vlerës 76,182,252 lekë** nga shoqëria "██████████" shpk. Kjo çështje do të verifikohet nga KLSH-ja, në vijimësi në programet e zbatimit të rekomandimeve.

**Brenda datës 31.12.2016**

### **6. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Instalim i sistemit të ventilim - kondicionimit (██████████) në ndërtesën HEC Fierzë", viti 2015, u konstatua se janë rritur në mënyrë të paargumentuar dhe të pabazuar ligjërishit shpenzimet në fazën e hartimit të preventivit dhe të zbatimit të kësaj kontrate, për zërin "testim - komisionim i pajisjeve dhe

sistemit” në vlerën 336,000 lekë, i cili është pjesë integrale e zërave të tjerë të punimeve të kësaj kontrate, duke rënduar padrejtësisht koston e investimit (*Trajtuar më hollësisht në faqet 64-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Administratori i Shoqërisë të shqyrtojë **vlerën 336,000 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit “Instalim i sistemit të ventilim–kondicionimit (██████) në ndërtesën HEC Fierzë”, viti 2015, pasi në strukturën e preventivit të këtij projekti, është vendosur zëri testim komisioni i pajisjeve dhe sistemit në vlerën 366,800 lekë, ndërsa në ofertën fituese është paraqitur vlera 336,000 lekë, vlerë e cila ka rënduar padrejtësisht koston e investimit. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për Shoqërinë “Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare” dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

**Brenda datës 31.10.2016**

**7. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Mobilimi i zyrave të reja në Njësinë Prodhuese HEC Fierzë”, viti 2015, u konstatua se shpallja fitues e operatorit ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer **në mënyrë të padrejtë**, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurës administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 115-120, **duke krijuar një dëm ekonomik në vlerën 2,826,645 lekë** (*Trajtuar më hollësisht në faqet 64-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Administratori i Shoqërisë të shqyrtojë **vlerën 2,826,645 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit “Mobilimi i zyrave të reja në Njësinë Prodhuese HEC Fierzë”. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për shoqërinë “Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare” dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

**Brenda datës 31.10.2016**

**8. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga “██████” me objekt “Sistemimi dhe asfaltimi i rrugës serpentinë përgjatë digës dhe ndriçimi i saj Hec Fierzë”, **viti 2015**, u konstatua se dokumentacioni teknik i zbatimit dhe kolaudimit të punimeve të ndërtimit nuk është i plotë dhe i saktë, duke krijuar një dëm ekonomik për llogari të shoqërisë KESH sha dhe Buxhetit të Shtetit në **vlerën 3,539,441 lekë** (*Trajtuar më hollësisht në faqet 64-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 3,539,441 lekë**, nga “██████” sh.p.k ,për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt “Sistemimi dhe asfaltimi i rrugës serpentinë përgjatë digës dhe ndriçimi i saj Hec Fierzë”, viti 2015, vlerë e cila për Shoqërinë “Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare” dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

**Brenda datës 31.10.2016**

**9. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i zbatimit të kontratës nga "██████████" sh.p.k me objekt "Ndërtim prita malore dhe punime mirëmbajtje tek përrenjtë e gropave të Nik Gjeçit", viti 2015, u konstatua se dokumentacioni teknik i zbatimit dhe kolauditimit të punimeve të ndërtimit, nuk është i plotë dhe i saktë, duke krijuar një dëm ekonomik për llogari të shoqërisë KESH sha dhe Buxhetit të Shtetit në vlerën **3,535,356 lekë** (Trajtuar më hollësisht në faqet 64-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **3,535,356 lekë** nga shoqëria "██████████" sh.p.k për shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës me objekt "Ndërtim prita malore dhe punime mirëmbajtje tek përrenjtë e gropave të Nik Gjeçit", viti 2015, vlerë e cila për Shoqërinë "Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare" dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik.**

**Brenda datës 31.10.2016**

**10. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Meremetim dhe lysterje e fasadës së godinës ekzistuese, murit tek shkarkuesit si dhe kanalit të largimit të ujërave përpara transformatorëve të fuqisë në HEC Fierzë", viti 2015, u konstatua se shpallja fitues e operatorit ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer **në mënyrë të padrejtë**, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit", Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i procedurës administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, nenet 115-120, duke krijuar një dëm ekonomik në vlerën **967,897lekë** (Trajtuar më hollësisht në faqet 64-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Administratori i Shoqërisë të shqyrtojë vlerën **967,897 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit "Meremetim dhe lysterje e fasadës së godinës ekzistuese, murit tek shkarkuesit si dhe kanalit të largimit të ujërave përpara transformatorëve të fuqisë në HEC Fierzë", 2015. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për shoqërinë "Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare" dhe Buxhetin e shtetit, **përbën dëm ekonomik.**

**Brenda datës 31.10.2016**

**11. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "Rikonstruksioni i godinës të administratës Vau i Dejës", viti 2015, u konstatua se shpallja fitues e operatorit ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer **në mënyrë të padrejtë**, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit", Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 "Kodi i procedurës administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, nenet 115-120, , duke krijuar një dëm ekonomik në vlerën vlera **4,931,907 lekë** (Trajtuar më hollësisht në faqet 64-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**Për sa më sipër rekomandojmë:**

Administratori i Shoqërisë të shqyrtojë vlerën **4,931,907 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit "Rikonstruksioni i godinës të administratës Vau i Dejës", viti 2015. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse,

vlerë e cila për shoqërinë “Korporatën Elektroenergjitike Shqiptare” dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik.**

**Brenda datës 31.10.2016**

### **12. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt “Blerje pjesë këmbimi për nevoja e KESH sha”, viti 2015, me shoqërinë “██████████” shpk, u konstatua se dokumentacioni shoqërues i pajisjeve (test raporti i fabrikës) me **vlerë 15,590,371 lekë**, nuk është i plotë dhe i saktë.

Veprim në kundërshtim me ligjin nr. 10,489 datë 15.12.2011 “Për trajtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore”, neni 3 pika 11, 12, 16, 17, 18, 21 neni 8 , neni 9 dhe neni 10, si dhe VKM nr. 369, datë 27.3.2008 Për miratimin e rregullit teknik "Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve elektrike, të projektuara për përdorim brenda disa kufijve të tensionit".

Grupi i Auditimit referuar praktikës dokumentare të vënë në dispozicion, e cila rezultoi e pasaktë dhe me mangësi, nuk mund që të konfirmojë që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “██████████” shpk, ka fituar tenderin dhe është likuiduar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 64-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Nga Administratori i Shoqërisë të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një Grupi teknik me specialistë të fushës (përrjashtuar ata që kanë marrë pjesë në kolaudimin dhe marrjen në dorëzim të pajisjeve), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e pajisjeve, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar (specifikimeve teknike), si dhe të verifikojë gjendjen e tyre teknike pas vendosjes në punë, nëse kanë qenë ose jo problematike.

Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se pajisjet e furnizuara nga shoqëria “██████████” shpk, nuk janë autentike, nuk janë konform specifikimeve teknike të përcaktuar në procedurën e tenderimit, dhe gjendja e tyre teknike pas vendosjes në punë ka qenë problematike (defekte etj), **konsiderohet dëm ekonomik** dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit **arkëtimi i vlerës 15,590,371 lekë** nga shoqëria “██████████” shpk. Kjo çështje do të verifikohet nga KLSH-ja, në vijimësi në programet e zbatimit të rekomandimeve.

**Brenda datës 31.12.2016**

### **13. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i shitblerjes së energjisë elektrike, u konstatua se janë krijuar efekte financiare dhe tatimore në zbatim të Vendimeve të Entit Rregullator të Energjisë nr. 27, datë 16.02.2015, nr. 143, datë 26.12.2014 , nr. 144, datë 26.12.2014 dhe nr. 149, datë 24.12.2013 për çmimet e blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël privatë dhe koncesionarë. Për vitin 2015, Enti i Rregullator i Energjisë me vendim nr. 27, datë 16.02.2015 ka miratuar tarifën fikse të energjisë elektrike që do tu paguhet prodhuesve të energjisë elektrike (HEC-et privat dhe me koncesion), në vlerën 7,636 lekë/ kwh.

Sasia e prodhuar nga këto HEC-et (koncesion dhe privat), nga Korporata Energjike Shqiptare, i është shitur OSHEE sha me çmim njësi prej 3 lekë/Kwh, me një diferencë të çmimit 4,636 lekë/ kwh, ndërsa nga Shoqëria Energji Ashta” është blerë 8.22 lekë/Kwh i është shitur OSHEE sha. me çmim njësi prej 3 lekë/Kwh, me një diferencë të çmimit 5.22 lekë/Kwh.

Nga ky transaksion, blerje nga HEC-et privat dhe me koncesion dhe shitje OSHEE sha, Korporatës Energjetike Shqiptare i është krijuar një efekt financiar negativ për llogari të buxhetit të saj në vlerën 49,740,818 euro. Në një kohë Korporata Energjike Shqiptare ka



marrë overdrafte në vlerën 46,000,000 euro dhe 24,924,000 lekë, me normë interes vjetor respektivisht 3.53 % në euro dhe 4.69 % në lekë.

Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë me Vendimet nr. 143, datë 26.12.2014 dhe nr. 144, datë 26.12.2014, vendosi rishikimin e çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për vitet 2013 e 2014 për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike (HEC-et e vegjël ekzistues, privatë apo koncesionarë si dhe HEC-et e vegjël të rinj koncesionarë) që kanë kontratë shit-blerje me KESH sha.

#### ***Në parantezë***

*Me vendimin nr. 143, datë 26.12.2014 ERE-s për rishikimin e çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licensuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistuese me fuqi të instaluar deri në 15 MW, për vitet 2013 dhe 2014 është përcaktuar që çmimi unik i shitjes së energjisë elektrike do të jetë 7.53 lekë/kwh.*

*Me vendimin Nr. 144 datë 26.12.2014 ERE-s për rishikimin e çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licensuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e rinjë me fuqi të instaluar deri në 15 MW, për vitet 2013 dhe 2014 është përcaktuar që çmimi unik i shitjes së energjisë elektrike do të jetë respektivisht 9.73 lekë/kwh për 2013 dhe 7.95 lekë/kwh për 2014.*

Nga rishikimi dhe reflektimi i këtyre çmimeve në kontratat dhe faturat me HEC-et prodhuese, KESH sha për vitin 2013 i është shkaktuar një efekt financiar **negativ** në vlerën 170,001,337.02 lekë ose 1,214,295 euro me tvsh, ndërsa për vitin 2014 ky efekt ka rezultuar **pozitiv** në vlerë 989,880,240 lekë ose 7,070,573 euro.

Në zbatim të vendimit të ERE nr. 149, datë 24.12.2013, Shoqëria KESH ka blerë energjinë elektrike nga prodhuesit e vegjël privatë e koncesionarë të energjisë elektrike, me çmim 7.77 lekë/kwh dhe 9.3 lekë/kwh respektivisht për HEC me koncesion dhe ato private, dhe këtë energji e kanë shitur OSHEE-së me çmim 2.2 lekë/kwh. Nga miratimi i dy vendimeve rishikues 143 dhe 144 të ERE, *rezulton se KESH sha ka paguar më tepër para për energjinë e blerë e për rrjedhojë është kërkuar sistemimi i vlerave me HEC-et e vegjël.*

Me rishikimin e vendimit nr. 149 të ERE-s dhe miratimin e vendimit 143 dhe 144 me fuqi prapavepruese për rishikimin e çmimit unik të shitjes së energjisë nga 9.3 lekë/kw në 7.95 lekë/kwh për hidrocentralet e rinj deri në 15mw dhe nga 7.77 lekë/kw në 7.53 lekë/kwh për hidrocentralet ekzistues deri në 15 mw fuqi, te cilat kane përkeqësuar treguesit ekonomiko-financiar të *KESH sha*.

**Nga miratimi dhe zbatimi i dy vendimeve rishikues rezulton se; sistemimi i faturave të energjisë elektrike ndaj HEC-eve të vegjël dhe me koncesion me çmimin e rishikuar ka filluar të rregullohet nga ana e HEC-eve, duke lëshuar fatura rregulluese dhe kreditore për Shoqërinë KESH sha.**

***Për-pos kësaj***, në zbatim të Ligjit nr. 92/2014, datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 6, datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, **nuk mund të kryhen procedurat e kreditimit dhe rimbursimit të TVSH-së, duke i shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm ekonomik të përafërt në vlerën 10,377,244 lekë** (Trajtuar më hollësisht në faqet 132-184, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Nga Administratori i Shoqërisë të prezantohet në organet drejtuese vlera 819,878,902 lekë, që përfaqëson efekte financiare negativ për Shoqërinë KESH sha në zbatim të Vendimeve të Entit Rregullator të Energjisë nr. 27, datë 16.02.2015, nr. 143, datë 26.12.2014, nr. 144, datë 26.12.2014 dhe nr. 149, datë 24.12.2013 për çmimet e blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël privat dhe koncesionar, vlerë e cila përbën një efekt financiar negativ për Shoqërinë KESH sha dhe për Buxhetin e Shtetit, dhe në zbatim të Ligjit nr. 92/2014, datë

24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 6 , datë 30.01.2015 “Për Tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, **nuk mund të kryhen procedurat e kreditimit dhe rimbursimit të TVSH-së, duke i shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm ekonomik të përafërt në vlerën 10,377,244 lekë,**

**si dhe**

**Ti kërkohet** Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë të nxjerrin një akt rregullues të përbashkët, **detyruar për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve**, ku të jepet zgjidhja me kosto minimale (sa më pak penalitete) të situatës të krijuar, për Shoqërinë KESH sha dhe prodhuesit e vegjël privatë e konçesionarë të energjisë elektrike, për shmangien e penaliteteve përkatëse. Gjithashtu, nëpërmjet këtij akti, të përcaktohen procedurat rregulluese për efekt të kreditimit dhe rimbursimit të TVSH-së, nga Shoqëria KESH sha dhe prodhuesit e vegjël të energjisë elektrike, për rregullimet që duhet të kryhen për vitet 2013 dhe 2014, si rezultat i zbatimit të vendimeve të ERES nr. 143 dhe nr. 144, datë 26.12.2014.

**Brenda datës 31.12.2016**

#### **14. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurave të shitjes së energjisë elektrike, në kushtet e prurjeve të mëdha me qëllim mbajtjen e niveleve në rezervuarët në kufijtë e lejuar të shfrytëzimit në zbatim të Rregullores së shkarkimit të plotave dhe për të minimizuar shkarkimet pa prodhim energjie dhe parashikimit të motit, u konstatua një dëm ekonomik në vlerën **122,436 Euro ose 16,861,885 lekë.**

Ky dëm ka ardhur pasi, [REDAKTUAR] me detyrë Drejtor i Divizionit të Gjenerimit, [REDAKTUAR] me detyrë Drejtor i Departamentit të Shfrytëzimit *në afatin kohor më pak se 24 orë, kanë dhënë përlllogaritje të prodhimit të energjisë elektrike kontradiktore*, si dhe nga veprimet dhe mos veprimet e [REDAKTUAR] në cilësinë titullari i autoritetit shitës, me delegim kompetence nga Administratori i Shoqërisë, e cila nuk ka verifikuar dhe administruar situatën hidrike për datat 3-7/02/2015, si dhe nuk ka vënë në dijeni Administratorin e Shoqërisë, për anulimin e procedurës së shitjes së energjisë në datën 03.2.2015 dhe derdhjet e ujit të HEC Vau i Dejës pa prodhim energjie, pra pa përfitim financiar.

Veprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi [REDAKTUAR], me detyrë Drejtor i Divizionit të Gjenerimit, [REDAKTUAR] me detyrë Drejtor i Departamentit të Shfrytëzimit dhe [REDAKTUAR] në cilësinë titullari i autoritetit shitës, me delegim kompetencë në zbatim të autorizimit nr. 5, date 24.02.2014, me kompetencë të deleguar nga Administratori i shoqërisë (*Trajtuar më hollësisht në faqet 132-184, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

Të shqyrtohet nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Administratori i Shoqërisë vlera **122,436 euro ose 16,861,885 lekë.** Kjo vlerë ka të bëjë me anulimin e procedurës së shitjes së energjisë në datën 03.2.2015 dhe derdhje të prurjeve të ujit në HEC Vau i Dejës, pa përfitim financiar. Ky dëm ka ardhur pasi, [REDAKTUAR] me detyrë Drejtor i Divizionit të Gjenerimit, [REDAKTUAR] me detyrë Drejtor i Departamentit të Shfrytëzimit *në afatin kohor më pak se 24 orë, kanë dhënë përlllogaritje të prodhimit të energjisë elektrike kontradiktore*, si dhe nga veprimet dhe mos veprimet e [REDAKTUAR] në cilësinë titullari i autoritetit shitës, me delegim kompetence nga Administratori i Shoqërisë, e cila nuk ka verifikuar dhe administruar situatën hidrike për datat 3-7/02/2015, si dhe nuk ka vënë në dijeni Administratorin e Shoqërisë, për anulimin e procedurës së shitjes së energjisë në datën 03.2.2015 dhe derdhjet e ujit të HEC Vau i Dejës pa prodhim energjie, pra pa përfitim financiar, **si dhe të evidentohen përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës, vlerë e cila për Shoqërinë KESH sha dhe Buxhetit të Shtetit, përbën dëm ekonomik.**

## B.2 TË ARDHURA TË MUNGUARA

### B.2.1. Gjetje nga auditimi:

Nga nënshkrimi dhe zbatimi i marrëveshjes me shoqërinë “██████████”, në zbatim të:

- 1. Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1363, datë 17.10.2008 “Për miratimin e marrëveshjes së koncesionit, ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “██████████”, për ndërtimin, pronësinë, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të një hidrocentrali të ri në ██████████, në Republikën e Shqipërisë botuar në fletoren zyrtare nr. 163, datë 22.10.2008;
- 2. Marrëveshjes për Shitjen e Energjisë Elektrike (Off-Take Agreement), botuar në fletoren Zyrtare nr. 163/1, datë 22.10.2008;
- 3. Marrëveshjes për Koordinimin e Kaskadës mbi ██████████ botuar në fletoren Zyrtare nr. 163/1, datë 22.10.2008;
- 4. Marrëveshjes së Ndërlidhjes (Interconnection Agreement), datë 07.05.2013.

*Është krijuar:* Reduktim i kapacitetit energjetik për HEC Vau Dejës, për Shoqërinë “Korporatën Energjetike Shqiptare” Sha në vlerën 3,880,430 euro.

*Në mënyrë të detajuar si më poshtë:*

HEC Vau Dejës është vënë në shfrytëzim në vitin 1972, sipas projektit fillestar ku niveli normal i ujit në bjefin e poshtëm gjatë punës së turbinave ka qënë projektuar nga kuota 21m mbi nivelin e detit deri në 23 m mbi nivelin e detit (mnd). Bjefi i poshtëm i HEC Vau Dejës, sipas projektit fillestar, është projektuar të variojë nga 21m (mnd) në 23 m(mnd). Regjimi i punës së turbinave HEC Vau Dejës, ka vazhduar normalisht sipas projektit fillestar të kësaj veprë, pra me nivel të ujit në bjefin e poshtëm dhe rezervuarin e Spatharës nga 21m (mnd) deri në 23m(mnd). Ky regjim pune ka vazhduar qysh nga vënia në shfrytëzim të HEC Vau Dejës (Tetor 1972) deri në (Maj të vitit 2012), ku u vu në shfrytëzim ██████████, pra për rreth 40 vjet.

Pas ndërtimit dhe vënies në shfrytëzim të ██████████, i cili shfrytëzon potencialin hidrik të ujit që shkarkohet nga HEC Vau Dejës dhe nga niveli i ujit në rezervuarin e Spatharit, për rrjedhojë edhe në bjefin e poshtëm të HEC Vau Dejës, i cili kontrollohet nga ██████████. Kjo është realizuar nga ██████████ me anë të mbi lartësimit të pragut të shkarkimit në rezervuarin e Spathar nga 21m (mnd) në 23m (mnd), që në kushtet e shkarkimeve maksimale nga turbinat e HEC Vau Dejës prej 560 m<sup>3</sup>/sek, rezulton me rritjen e nivelit në bjefin e poshtëm të HEC Vau Dejës deri në 23.60 m.

Mbajtja e nivelit të ujit në rezervuarin e Spatharës në mënyrë të vazhdueshme në kuotën 23 m (mnd) ka shkaktuar edhe mbajtjen e nivelit të ujit të bjefit të poshtëm të HEC Vau Dejës në mënyrë të vazhdueshme, nga regjistrimet në kohe reale të paraqitura ██████████, në kuotën 23,33 m (mnd), duke shkaktuar për rrjedhojë rritjen e kuotës së bjefit të poshtëm mesatarisht me 1m më shumë se kuota që ka rezultuar nga operimi vetëm i HEC Vau Dejës për 40 vite me radhë. Kjo do të thotë zvogëlim të lartësisë së rënies së ujit (diferenca e kuotave të bjefit të sipërm me atë të bjefit të poshtëm) në turbinat e HEC Vau Dejës me 1m (mesatare vjetore), që do të thotë për të njëjtën sasi uji që shkarkohet nga turbinat e HEC Vau Dejës, prodhohet më pak energji elektrike (rreth 2% e prodhimit të përgjithshëm të HEC Vau Dejës) nga sa është prodhuar nga HEC Vau Dejës përpara vënies në shfrytëzim të ██████████.

Nga të dhënat e shfrytëzimit të vazhdueshëm, të regjistruara mbi baze orare nga Dispeceria e KESH sha, treguesit kryesorë mesatar të shfrytëzimit në HEC V. Dejës, kanë rezultuar:

*a-Para vendosjes së ██████████:*

Për vitin 2010 -niveli mesatar i poshtëm 23.22 m, H = 51.6 m.

Shkarkime V. Dejës 565 m<sup>3</sup>/sek, prodhimi 1511 Gwh.

Për vitin 2011- niveli mesatar i poshtëm 22.05 m, H = 51.2 m.

Shkarkime V. Dejës 217 m<sup>3</sup>/sek, prodhimi 815.7Gwh.

*b-Pas vendosjes së* [REDACTED]

Për vitin 2012 - niveli mesatar i poshtëm 22.8 m (regjistrime të “KESH”), H = 51.39 m.

Shkarkime V. Dejës 276m<sup>3</sup>/sek, prodhimi 610 Gwh (Qershor-Dhjetor).

Niveli mesatar i poshtëm sipas projektit e shfrytëzimit 22.22 m.

Për vitin 2013 - niveli mesatar i poshtëm 23.33 m, H = 51.08 m.

Shkarkime V.Dejës 394 m<sup>3</sup>/sek, prodhimi 1314.9 Gwh.

Niveli mesatar i poshtëm sipas projektit e shfrytëzimit 22.64 m.

Për vitin 2014 - niveli mesatar i poshtëm 23.33 m, H = 51.04 m.

Shkarkime V.Dejës 215 m<sup>3</sup>/sek, prodhimi 802.3 Gwh.

Niveli mesatar i poshtëm sipas projektit e shfrytëzimit 21.98 m.

Për vitin 2015 - niveli mesatar i poshtëm 23.33 m, H = 50.81 m.

Shkarkime V.Dejës 360m<sup>3</sup>/sek, prodhimi 529.8 Gwh (Janar-Maj).

Niveli mesatar i poshtëm sipas projektit e shfrytëzimit 22.52 m.

- Niveli mesatar i poshtëm 23.33 m, është sipas matjeve të dhëna nga Shoqëria “[REDACTED]” shpk (të marra në kohë reale nga pajisjet e vendosura në V.Dejës)

*Diferenca midis niveleve të projektit të zbatuar gjatë shfrytëzimit të vazhdueshëm të V.Dejës dhe nivelit të vendosur nga Shoqëria “[REDACTED]” shpk, është reduktim i kapacitetit energjetik për HEC Vau Dejës, reduktim i cili për periudhën Qershor 2012 – Dhjetor 2015 është gjithsej në sasinë 65.77 GWh, me vlerën 3,880,430 euro (Trajtuar më hollësisht në faqet 132-184, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

- Këshilli Mbikëqyrës, Administratori i Shoqërisë dhe Ministria e Zhvillimit Ekonomik të marrin masa për të rinegociuar marrëveshjen me shoqërinë “[REDACTED]” me qëllimin e rikuperimit në vitet në vazhdim të vlerës prej të **3,880,430 euro**, si dhe shtimin e prodhimit të energjisë elektrike në Kaskadën e Drinit.

**Brenda datës 31.12.2016**

### **B.2.2. Gjetje nga auditimi:**

Nga auditimi i procedurave të blerjes së energjisë elektrike për vitin 2015, dhe krahasimi me shitjen e po të njëjtës sasi energjie në të njëjtën periudhë sipas muajve respektivë nga kompania KESH sha tek operatorët privat të tregut të energjisë, vihet re një diferencë e madhe midis çmimit të shitjes së energjisë nga KESH sha dhe çmimit të blerjes së energjisë nga OSHEE sha, me një diferencë çmimi prej rreth - 24.38 Euro/Mwh me vlerë totale diferencë 7,255,176 Euro.

*Në qoftë se KESH sha do e kishte shitur energjinë direkt OSHEE-së me çmimin e eksportit prej 30.43 euro, për sasinë 297,600 Mwh, OSHEE-ja do të kishte kursyer 7,255,176 euro, dhe kjo vlerë nuk do të kalonte për llogari të kompanive që operojnë në tregun e energjisë në Shqipëri si: [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED] sh.p.k etj.*

Pra këto shoqëri, energjinë e prodhuar nga shteti shqiptar (me kontributin e taksa paguesve shqiptar) e marrin nga shteti me çmim mesatar 30.43 euro dhe ja shesin shtetit shqiptar me çmim mesatar 54.81 euro me një diferencë 24.38 Euro/Mwh, duke i krijuar një humbje të drejtpërdrejtë buxhetit të shtetit dhe në fund të fundit një detyrim financiar që e paguan konsumatori fundor shqiptar.

Kjo situatë është krijuar sepse:

ERE me veprimet apo mosveprimet e saj, ka krijuar një situatë konfuzë në sistemin energjetik, jo vetëm në aktet e nxjerra, por dhe në monitorimin e shoqërive që operojnë në

sistemin energjetik, si dhe me mungesën e analizës së këtij tregu nga ana e saj, me pasojë financiare për buxhetin e shtetit.

Shoqëria KESH sha, ende nuk ka një plan të optimizimit të burimeve hidroenergjetike mbi baza vjetore, mujore, javore dhe ditore, çka ka sjell si pasojë humbje të konsiderueshme të të ardhurave nga shitja e energjisë elektrike, si dhe shpenzime të tepërta pa efektivitet në rastin e blerjes së energjisë elektrike për Shoqërinë KESH sha, që në dy rastet cenon buxhetin e shtetit në tërësi

Shoqëria KESH sha, aktualisht operon në tregun e energjisë elektrike në funksionin e Prodhuesit Publik dhe Furnizuesit Publik me Shumicë. Në vitin 2015 në kuadër të ristrukturimit të sektorit të energjisë elektrike, si dhe të përgjegjësive dhe detyrave, si pjesëmarrës në Traktatin e Komunitetit të Energjisë së Evropës Juglindore u miratua ligji nr. 43/2015, datë 30.04.2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”. Ky ligj përafron plotësisht direktivën 2009/72/KE “Mbi Rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike”, si pjesë e paketës së tretë legjislativë evropiane për energjinë.

Qëllimi i ligjit është të garantojë furnizimin e qëndrueshëm dhe të sigurt me energji elektrike të konsumatorëve, nëpërmjet krijimit të tregut funksional dhe konkurrues të energjisë elektrike, duke marrë në konsideratë interesat e konsumatorëve, sigurinë dhe cilësinë e furnizimit me energji elektrike, gjithashtu edhe kërkesat për mbrojtjen e mjedisit.

E veçantë e këtij ligji, është derregullimi që ai i bën segmenteve deri tani të rregulluar të energjisë elektrike, duke bërë një ndarje të qartë të funksionimit të tregut me shumicë dhe atij me pakicë të energjisë elektrike. Ndonëse mund të konsiderohet, se ky ligj përbën një hap përpara për zhvillimin e sektorit elektroenergjetik shqiptar, ai gjithashtu parashikon një periudhë tranzitore, gjatë së cilës tregu i energjisë elektrike do të vazhdojë të operojë sipas kuadrit rregullator të mëparshëm, përse ky kuadër ligjor dhe rregullator nuk bie në kundërshtim me ligjin 43/2015, datë 30.04.2015 “Për Sektorin e energjisë Elektrike”.

Miratimi sa më i shpejtë i akteve nënligjore e rregullatore në zbatim të ligjit 43/2015, do të bënte të mundur operimin e KESH sha, në kushtet e një tregu konkurrues, duke mënjanuar kostot e panevojshme dhe duke rritur performancën financiare të shoqërisë.

Vendosja e detyrimit për shërbim publik ndaj KESH sha, duhet të ofrojë mundësinë që jo vetëm të kufizojë KESH sha në interes të përgjithshëm publik, por ti japë frymëmarrje graduale komercializimit të mëtejshëm të shoqërisë në tregun vendas dhe rajonal të energjisë elektrike, me synimin e përmirësimit të treguesve të performancës financiare dhe orientimit të aktiviteteve operacionale në përputhje me misionin e shoqërisë (*Trajtuar më hollësisht në faqet 132-184, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

-Nga Administratori i Shoqërisë të prezantohet në organet drejtuese **vlera 7,255,176 euro**, që përfaqëson diferencën midis çmimit të shitjes së energjisë nga KESH sha dhe çmimit të blerjes së energjisë nga OSHEE sha, me një diferencë çmimi prej rreth -24.38 Euro/Mwh me vlerë totale diference **7,255,176 Euro, vlerë e cila përbën një të ardhur të munguar për Shoqërinë KESH sha dhe për Buxhetin e Shtetit**, si dhe të zbatohet me rigorozitet dhe përgjegjësi vendimi i ERE nr. 12 datë 06.02.2015 .

**Brenda datës 31.10.2016**

### **B.2.3 MOSREALIZIMI ME EFEKTIVITET I SHPENZIMEVE**

- Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion rezulton se KESH Sha ka nënshkruar marrëveshjen e shitjes së energjisë lidhur me një projekt të ri hidrocentrali në [REDAKTUAR] Republika e Shqipërisë ndërmjet "[REDAKTUAR]" dhe Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare, me datë 30.09.2008, botuar në fletoren Zyrtare nr. 163/1, datë 22.10.2008.

Midis të tjerave, në pikën 3- Çmimi për njësi, pagesa dhe faturimi, çështja 3.1 Pagesa e blerësit, është përcaktuar çmimi për njësi 5.9 Euro-Cent/kah (pra 59 Euro Mwh), për një afat prej 15 vjet ( pika 8, çështja 8.1.2/a e marrëveshjes). Sipas të dhënave të KESH Sha, rezulton se në periudhën 2 korrik 2013 - 25 mars 2016, energjia elektrike e blerë nga ky koncesionar (Shoqëria "[REDAKTUAR]" shpk) është në sasinë 649,310 Mwh, për vlerën 45,971,147 Euro gjithsej (sipas çmimit të përcaktuar në marrëveshje prej 59 euro/Mwh).

Grupi i auditimit e ka analizuar këto marrëveshje dhe në kuadër të performancës së çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Shoqëria "[REDAKTUAR]" shpk dhe të blerë nga KESH Sha.

Referuar të dhënave të KESH Sha për çmimin mesatar të importit të energjisë elektrike të realizuar prej saj në periudhën e mësipërme, rezulton të jetë 51.05 Euro/Mwh, me një diferencë më pak prej 7.95 Euro/Mwh. Kjo do të thotë se për të njëjtën sasi energjie prej 649,310 Mwh të blerë prej Shoqërisë "[REDAKTUAR]" shpk me çmim të përcaktuar sipas marrëveshjes, KESH-it, buxhetit dhe shoqërisë shqiptare do të kishte kushtuar më pak 6,194,417 euro.

Nga sa më sipër rezulton se, fiksimi në marrëveshje i çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga Shoqëria "[REDAKTUAR]" shpk dhe të blerë nga KESH Sha për një periudhë të caktuar kohore, ka qenë jo efektiv. Duhet theksuar se vendosja e çmimeve fikse, të pa kondicionuar me rrethana të tjera si çmimi i bursës, indeksimi i inflacionit, përqindja e fitimit etj., mund të ndikojë negativisht tek investitorët e huaj, duke mos i shërbyer zgjerimit të pjesëmarrjes së tyre në zhvillimin ekonomik të vendit.

- Sipas marrëveshjes së mësipërme, likuidimi nga KESH Sha i energjisë së prodhuar nga Shoqëria "[REDAKTUAR]" duhet të bëhet mbi bazën e deklarimeve të kësaj të fundit dhe jo mbi bazën e prodhimit real të saj. Sipas të dhënave të disponueshme nga KESH Sha, në periudhën prill-maj-qershor 2013, është krijuar një diferencë në vlerë prej 473,782 Euro gjithsej (nga të cilat 106,101.7 Euro janë kamat-vonesa) për sasinë e prodhimit të deklaruar dhe atij faktik të likuiduar. Në këtë mënyrë vlera e mësipërme konsiderohet si joefektive për shpenzimet e KESH Sha (*Trajtuar më hollësisht në faqet 132-184, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

#### **Për sa më sipër rekomandojmë:**

- Këshilli Mbikëqyrës, Administratori i Shoqërisë dhe Ministria e Energjisë dhe Industrisë të marrin në analizë, të rishqyrtojnë dhe të rinegociojnë Marrëveshjen me shoqërinë "[REDAKTUAR]" Shpk, me qëllim që të përcaktohet një çmim i favorshëm dhe real për palët në marrëveshje duke marrë në konsideratë dhe faktorë të tjerë si çmimi i bursës, indeksi i inflacionit, përqindja e fitimit të investitorit etj. Gjithashtu, gjatë procedurës së mësipërme, të shqyrtohet dhe të saktësohet problematika e lidhur me bazën e likuidimeve (mbi bazë deklarimi ose/edhe prodhimi faktik), me synim rritjen e efektivitetit të investimeve energjetike.

**Brenda datës 31.12.2016**

### **C. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, kontratës kolektive të punës neni 62, kontratave individuale të punës, pika 7, i kërkojmë Administratorit të Shoqërisë, që në varësi të kompetencave të tij ligjore, të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

## **I. “Zgjidhje të kontratës së punësimit” për:**

**1. I B** me detyrë Drejtor i Divizionit të Gjenerimit, për arsye se:

- në kushtet e prurjeve të mëdha në HEC Vau i Dejës me qëllim mbajtjen e niveleve në rezervuarë në kufijtë e lejuar të shfrytëzimit në zbatim të Rregullores së shkarkimit të plotave, dhe për të minimizuar shkarkimet pa prodhim energjie dhe parashikimit të motit, u konstatua një dëm ekonomik në vlerën **122,436 euro ose 16,861,885 lekë**.

Ky dëm ka ardhur pasi, në afatin kohor më pak se 24 orë, janë dhënë përllogaritje të prodhimit të energjisë elektrike, kontradiktore. E cila ka sjellë, anulimin e procedurës së shitjes së energjisë në datën 03.2.2015 dhe derdhje të prurjeve të ujit në HEC Vau i Dejës, pa përfitim financiar.

- për miratimin dhe kalimin për ekzekutim drejtorisë së investimeve, të projektit “Sistemimi dhe asfaltimi i rrugës serpentinë përgjatë digës dhe ndriçimi i saj, në Hec Fierzë. Investimi është kryer pa leje ndërtimi veprim në kundërshtim me VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për disiplinimin dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Ligjin 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit.

- projekti është hartuar dhe zbatuar **pa oponencë teknike**, veprim në kundërshtim me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1055, datë 22.12.2010 “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit” dhe urdhrin e Ministrit të Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit nr. 7, datë 20.1.2014 “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”.

- Në llogaritjen e vlerës së kontratës nuk është marrë në konsideratë fakti që projekt i zbatimit nuk është i hartuar sipas kushteve teknike të zbatimit të miratuar me VKM nr. 68, datë 15.02.2001 “Për miratimin e standardeve dhe kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit të punimeve të ndërtimit”. Projekti nuk pasqyron llogaritjet konstruktive dhe volumet.

Për pos kësaj, nuk ka një analizë të detajuar mbi bazën e të cilës është llogaritur çdo zë i preventivit konform Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 568, datë 27.6.2013 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 132-184, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2. B S**, me detyrë Drejtor i Departamentit të Shfrytëzimit në Divizionin e Gjenerimit, për arsye se:

- në kushtet e prurjeve të mëdha në HEC Vau i Dejës me qëllim mbajtjen e niveleve në rezervuarë në kufijtë e lejuar të shfrytëzimit në zbatim të Rregullores së shkarkimit të plotave, dhe për të minimizuar shkarkimet pa prodhim energjie dhe parashikimit të motit, u konstatua një dëm ekonomik në vlerën **122,436 euro ose 16,861,885 lekë**.

Ky dëm ka ardhur pasi, në afatin kohor më pak se 24 orë, janë dhënë përllogaritje të prodhimit të energjisë elektrike, kontradiktore. E cila ka sjellë, anulimin e procedurës së shitjes së energjisë në datën 03.2.2015 dhe derdhje të prurjeve të ujit në HEC Vau i Dejës, pa përfitim financiar (*Trajtuar më hollësisht në faqet 132-184, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3. S H**, me detyrë inxhinier remonti, reparti mekanik HEC Fierzë, në cilësinë e anëtarit të komisionit kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim, për arsye se:

-në zbatimin e kontratës në tenderin e zhvilluar me objekt: “Blerje pjesë këmbimi për nevoja KESH”, viti 2015, u konstatua një përfitim i padrejtë nga shoqëria “██████████” shpk në vlerën **15,590,371 lekë**, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare dhe Buxhetin e Shtetit (*Trajtuar më hollësisht në faqet 64-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4. E Gj**, me detyrë inxhinier i kontrollit dhe monitorimit, reparti elektrik HEC Fierzë, në cilësinë e anëtarit të komisionit të marrjes në dorëzim, për arsye se:

-në zbatimin e kontratës në tenderin e zhvilluar me objekt “Instalim i sistemit të ventilim-kondicionimit (██████████) në ndërtesën HEC Fierzë”, viti 2015, u konstatua një përfitim i padrejtë nga shoqëria “██████████” sh.p.k në vlerën **76,182,252 lekë**, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare dhe Buxhetin e Shtetit (*Trajtuar më hollësisht në faqet 64-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**I.1** Gjatë trajtimit të çështjeve në Raportin Përfundimtar të auditimit janë konstatuar përgjegjësitë të natyrës administrative për personat që nuk janë në marrëdhënie pune me KESH sha, të cilat do të vlerësoheshin me masën disiplinore:

“**Zgjidhje të kontratës së punësimit**” për:

**5. K F**, me detyrë Zëvendës administratore për periudhën 10.02.2014 deri 01.03.2016.

**6. H V**, me detyrë Administratori i Shoqërisë KESH sha në periudhën 12.04.2013 deri në 30.09.2013.

**7. E M**, me detyrë drejtor i DFPSH për periudhën 16.05.2013 deri 04.10.2013.

**II.** Nga “Vërejtje” deri në “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje kontrate”, për:

**1. L B**, me detyrë përgjegjës i repartit hidroteknik në HEC Fierzë, për arsye se: Investimi i “Sistemimit dhe asfaltimit të rrugës serpentinë përgjatë digës dhe ndriçimi i saj”, në Hec Fierzë, është kryer pa leje ndërtimi veprim në kundërshtim me VKM Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për disiplinimin dhe kontrollin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Ligjin 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit (*Trajtuar më hollësisht në faqet 132-184, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2. A V**, me detyrë specialist i sigurimit teknik në HEC Fierzë, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave.

**3. M V**, me detyrë protokollist/arshivist në HEC Fierzë, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave.

Për arsye se;

- në procedurën e prokurimit me objekt “Mobilimi i zyrave të reja në Njësinë Prodhuese HEC Fierzë”, viti 2015, shpallja fitues e operatorit ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer **në mënyrë të padrejtë**, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurës administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 115-120, duke krijuar një dëm ekonomik në vlerën **2,826,645 lekë**.

-në procedurën e prokurimit me objekt “Meremetim dhe lysterje e fasadës së godinës ekzistuese, murit tek shkarkuesit si dhe kanalit të largimit të ujërave përpara transformatorëve të fuqisë në HEC Fierzë”, viti 2015, shpallja fitues e operatorit ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer **në mënyrë të padrejtë**, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”,



Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurës administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 115-120, duke krijuar një dëm ekonomik në vlerën **967,897lekë** (Trajtuar më hollësisht në faqet 64-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

### III. “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje kontrate” për:

1. **K Gj**, me detyrë shef sektori, sektori i mirëmbajtjes HEC Vau Dejës, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave.

2. **R H**, me detyrë ekonomiste, sektori ekonomik HEC Vau Dejës, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave.

3. **Rr D**, me detyrë përgjegjës reparti, reparti hidroteknik HEC Vau i Dejës, në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave.

Për arsye se në procedurën e prokurimit me objekt “Rikonstruksioni i godinës të administratës Vau i Dejës”, viti 2015, shpallja fitues e operatorit ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer **në mënyrë të padrejtë**, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurës administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 115-120, , duke krijuar një dëm ekonomik në vlerën **4,931,907 lekë** (Trajtuar më hollësisht në faqet 64-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4. **B H**, me detyrë inxhinier remonti, reparti mekanik HEC Fierzë, në cilësinë e anëtarit të komisionit të marrjes në dorëzim.

5. **S H**, me detyrë inxhinier mbrojtje rele dhe komandimi, reparti elektrik HEC Fierzë, në cilësinë e anëtarit të komisionit të marrjes në dorëzim.

6. **G Gj**, me detyrë teknik specialist ekspert i kualifikuar, departamenti i mirëmbajtjes, sektori elektrik, në cilësinë e anëtarit të komisionit kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim.

7. **A M**, me detyrë teknik specialist ekspert, departamenti i mirëmbajtjes, sektori elektrik, në cilësinë e anëtarit të komisionit kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim.

8. **K P**, me detyrë shef sektori, sektori teknik HEC Vau Dejës, në cilësinë e anëtarit të komisionit kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim.

9. **P V**, me detyrë përgjegjës reparti, reparti elektrik HEC Fierzë, në cilësinë e anëtarit të komisionit kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim.

Për arsye se në zbatimin e kontratës në tenderin e zhvilluar me objekt: “Blerje pjesë këmbimi për nevoja KESH”, viti 2015, u konstatua një përfitim i padrejtë nga shoqëria “██████████” shpk në vlerën **7,200,000 lekë**, vlerë e cila përbën dëm ekonomik për Korporatën Elektronergjetike Shqiptare dhe Buxhetin e Shtetit (Trajtuar më hollësisht në faqet 64-127, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**III.1** Gjatë trajtimit të çështjeve në Raportin Përfundimtar të auditimit janë konstatuar përgjegjësitë të natyrës administrative, për personat që nuk janë në marrëdhënie pune me KESH Sha, të cilat do të vlerësoheshin me masën disiplinore:

“Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje kontrate” për:

10. **L K**, me detyrë drejtor i DFPSH për periudhën 05.10.2013 deri 31.10.2013.

11. **E S**, me detyrë drejtor i DFPSH për periudhën 01.11.2013 deri 22.12.2014.

12. **P F**, me detyrë shef sektori ekonomik HEC Fierzë deri më 31.07.2015.

**Shënim:** Për punonjësit që aktualisht rezultojnë në marrëdhënie pune: E M, R K, E M, A N, B V, V V, E M, D T, T D, I I, P D, Z Sh, B C, Y N, I H, I Sh, A A, A M, K H, A Sh, D S, V B, R H, M M, A N, T P, A Ç, T Sh dhe A T të cilët edhe pse janë identifikuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, për disa të meta e mangësi që nuk i kapërcejnë kufijtë e shkëljes

administrative, për arsye se asnjë prej tyre gjatë përmbushjes së detyrave, nuk ka ndikuar negativisht apo ka sjellë pasoja të konsiderueshme në mirëfunksionimin e shoqërisë, konsiderojmë që për to, të mos propozohet masë.

Gjithashtu, për personat e cilësuar më lart me masa disiplinore, por që nuk janë në marrëdhënie pune me KESH Sha, masat disiplinore konsiderohen të ezauruar.

#### **IV. TË TJERA**

Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës dhe Departamenti i Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financimet e Huaja, Shoqërive Publike do të studiojë këtë material dhe do të propozojë përmirësime ligjore deri në fund të muajit gusht 2016.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financimet e Huaja dhe Shoqërive Publike.

---

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**